

**Njoftim për përqendrim me të cilin ORBICO SPORTSTYLE SHPK Itali do të fitojë kontroll mbi pjesë të pasurisë të LEVI STRAUSS & co EUROPE, Belgjikë dhe LEVI STRAUSS DE ESPANA S.A., Spanjë
(lënda nr. 08-170/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 26.11.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin ORBICO SPORTSTYLE SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, me seli në Via Dell'Agricoltura 51, CARPI (MO) CAP 41012, Itali, do të fitojë kontroll mbi pjesë të pasurisë dhe pjesë të veprimtarive afariste të: LEVI STRAUSS & co EUROPE, me seli në Bastioun Plein 1A, 1050 Ixelles, Belgjikë dhe LEVI STRAUSS DE ESPANA S.A., me seli në AV Diagonal, 561-565 R.3, Barcelona 08029, Spanjë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

ORBICO SPORTSTYLE SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, ka si objekt veprimtarie: prodhimin, shitjen dhe tregtinë e të gjitha llojeve të produkteve të konsumit të gjerë, duke përfshirë, pa përjashtim, veshje dhe aksesore, artikuj dhe pajisje sportive, këpucë, dhe i njëjti është në pronësi 100% të ORBICO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë. ORBICO SHPK për tregti Zagreb ka si objekt veprimtarie: tregtinë, dhe i njëjti është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

-Shoqëria për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Kisela Voda - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me objekt veprimtarie - veprimtari prioritare: 46.900 - tregti me shumicë e pa specializuar.

Transaksioni ka të bëjë me fitimin e kontrollit të plotë mbi pjesë të caktuara të pasurisë dhe pjesë të caktuara të veprimtarive afariste të: LEVI STRAUSS & co EUROPE me objekt veprimtarie - veprimtari prioritare: tregtia me shumicë e veshjeve, përveç uniformave të punës dhe të brendshmeve; dhe LEVI STRAUSS DE ESPANA S.A., me objekt veprimtarie - veprimtari prioritare: prodhimin e veshjeve të tjera dhe aksesoreve të modës.

Shoqëritë mbi pjesën e pasurisë së të cilave fitohet kontroll, nuk kanë prani korporative në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizojnë të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

28.11.2025

Shkup